

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.04.2023*

27.04.2023
Ora 15:05

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për 3 kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 15, 16, 17, për vendosje sanksioni administrativ dhe kërkesën ankimore nr. 52, me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

**KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike: PDIU, BF**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 27 prill 2023, ora 15:05 hidhet shorti për caktimin e relatorit, për tre kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe një kërkesë ankimore, me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në katër kemi vendosur kërkesat numër 15,16,17 dhe kërkesën ankimore numër 52, të cilat palosen dhe vendosen në gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Pasi janë vendosur të 5-të goglat në një enë transparente, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent në seancë, kanë dhënë autorizimin për të tërhequr në emër dhe për llogari të tyre një përfaqësues të KQZ-së duke filluar nga rendi alfabetik rritës duke filluar me zotin Ervin Lako.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.04.2023*

-Vazhdojmë në emër dhe llogari të:

Z. Elvis Çefa: -Tërhiqet gogla – Kërkesa e Komisionerit numër 16.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - Kërkesa e Komisionerit numër 15.

Vazhdojmë në emër dhe llogari të:

Z. Koli Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe llogari të:

Z. Ledio Braho: - Kërkesa e Komisionerit numër 17.

Atëherë në përfundim të procedurës së shortit, kërkesa ankimore numër 52 ka relator zotin Ervin Lako, kërkesa e Komisionerit numër 15 ka relator zotin Ilirjan Rusmali, kërkesa e Komisionerit numër 16 ka relator zotin Elvis Çefa dhe kërkesa e Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ me numër 17 ka relator zotin Ledio Braho, këtu përfundojmë dhe procedurën e shortit për caktimin e relatorit të kërkesave ankimore dhe kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ, ju, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

